

MONITOR

E PERJAVSHME VITI i VI i BOTIMIT NR. 18 (274) - 9 MAJ 2007 Çmimi 300 lekë, 3 EURO

BIZNES - EKONOMI - TREG

sigurimet motorike
TPL e liberalizuar pas 2008-ës

FAQE 33


industria e qumështit
MTL-të, fiton vetëm rajoni

FAQE 37

bankat
Orientim drejt tregut me pakicë

FAQE 16

ARBITRARITETI I PAGAVE



SPECIALE - TAKSAT

Nga vendimi i fundit i Qeverisë për caktimin e pagave, te ligji i gjobave, propozimet për legjislacion të ri, deri te shembulli i SHBA-ve për të luftuar evazionin me tatimin mbi të ardhurat

Nga 11 qershori

LINJË DIREKTE TIRANË - NJU JORK

Igli TASHI
Fakulteti i Ekonomisë,
Universiteti i Lozanës, Zvicër

Jemi gjendur shpeshherë të përballur me paradokse gjatë historisë sonë të afërt e të largët, të cilat na kanë kushtuar shtrenjtë si në pikëpamjen ekonomike po ashtu dhe në atë njerëzore. Shpeshherë jemi justifikuar si të pafuqishëm për të reaguar ndaj tyre dhe duke mos dashur të rihapim plagë që duhen mbyllur sa më shpejt të jetë e mundur, mund të përmendim farsën piramidale. Shpeshherë kemi vepruar në emër të neoliberalizmit ekonomik duke thyer çdo rregull moral dhe ekonomik të joshur nga motori ekonomik me emrin fitim, ashtu siç dhe shpeshherë të tjera jemi munduar të tregohemi më "katolikë se papa" duke aprovuar dhe zbatuar ligje apo moratoriume që asnjë regjim demokratik në një situatë normale nuk do të kishte mundur t'i imagjinonte. E mbarsur me një logjikë paradoksesh, legjislatori shqiptar ka votuar kohët e fundit të ashtuquajturin "ligji i gjobave", kjo në emër të luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal. I prirur nga morali profesional, duke mos dashur t'i jap artikullit tim një karakter politik, dëshiroj të theksoj që megjithë dëshirën e mirë që mund të ekzistojë për të minimizuar rëndësinë dhe ndikimin e këtij fenomeni në Shqipëri, rruga e preferuar nga legjislatori shqiptar është rruga më e gjatë dhe më e pafrytshme në këtë drejtim.

Kam ndjekur me shumë vëmendje diskutimet e politizuara dhe emocionale në lidhje me këtë ligj dhe të them të drejtën është me të vërtetë shumë e vështirë që në një atmosferë emocionale të logjikosh dhe të mendosh një zgjidhje racionale. Racionaliteti është një koncept shumë i rëndësishëm në teorinë ekonomike dhe si i tillë mungesa e tij në vendimmarrjet që lidhen direkt me fushën e ekonomisë dhe të biznesit bëjnë që këto vendimmarrje të kenë një ndikim shumë të vogël për të mos thënë negativ. Kjo është dhe një nga arsytet që ky ligj në formën dhe me mekanikat e propozuara nga qeveria shqiptare dhe njëkohësisht të aprovuara nga legjislatori shqiptar do të krijojë shumë probleme në dinamikën e ekonomisë shqiptare.

Pa dashur që ky artikull të marrë formën e një leksioni makroekonomie, duhet theksuar fakti që nocioni i racionalitetit është i lidhur ngushtë me nocionin e ekuilibrave ekonomikë, nocion ky shumë i rëndësishëm për sa i përket efikasitetit dhe eficiencës së politikave ekonomike. Ky ekuilibër duhet të jetë i pranishëm si në marrëdhëniet biznes-klient, në ato biznes-biznes po gjithashtu dhe në marrëdhëniet biznes-shtet. Kjo, sepse mbi të gjitha, guri themeltar dhe finaliteti i teorisë ekonomike liberale



INFORMALITETI DHE REALITETI SHQIPTAR

është racionaliteti i përkthyer ndryshe si rritja e mirëqenies për gjithë aktorët ekonomikë të sipërpërmendur. Pra, në bazën e asaj gjendjeje që quhet "ekuilibër ekonomik" ndodhet një ndërveprim multilateral i grupeve të interesit. Në këtë aspekt, ligji i aprovuar nga legjislatori shqiptar shkon kundër çdo lloj logjike ekuilibrash duke sjellë kështu një mungesë racionaliteti që fatkeqësisht mund të ketë efekte të rëndësishme në finalitetin e logjikës ekonomike, pra të rritjes së mirëqenies.

DERI KU NDËRHYN SHTETI

Ndërhyrja e shtetit në ekonominë e tregut është një subjekt shumë i diskutuar në botën ekonomike. Natyrisht, në këtë kuadër konsiderojmë politikën ekonomike liberale të demokracive drejt të cilave ne aspirojmë të bëhemi pjesë përbërëse, duke lënë mënjanë politikën ekonomike planifikuese të stilit komunist të komanduara drejtpërdrejt nga shteti. Në këtë aspekt ndërhyrja e shtetit në ekonominë e tregut konsiderohet si e nevojshme dhe e dëshirueshme për disa arsye. Më e rëndësishmja ndërmjet tyre është sepse ekonomia e tregut udhëhiqet nga logjika e fitimit. Kjo logjikë në

stadin më të lartë të saj i përafërsisht shumë logjikës së xhunglës ku gjithkush do të fitojë. Për këtë arsye ndërhyrja e shtetit si ekuilibruer ideal për të mos pasur pabarazi dhe diferenca të mëdha është e dëshirueshme. Problemi qëndron në faktin se deri ku shteti mundet të shkojë me ndërhyrjen e tij për të përmbushur rolin e ekuilibruerit dhe për të mos kaluar në një pozicion çekuilibruer. Kufiri është pothuajse i padukshëm.

"RRËNJËT E INFORMALITETIT"

Në radhë të parë informaliteti ekonomik si fenomen i referohet evazionit fiskal, por jo vetëm atij. Në termin informalitet përmblidhen të gjitha dukuritë e mosrespektimit të ligjeve dhe rregullave të vendosura dhe të pranura si të tilla nga ana e kompanive dhe bizneseve që operojnë në një vend të caktuar. Këtu mund të përmendim përveç evazionit fiskal, mosrespektimin e rregullave të punëdhënies, të rregullave të prodhimit etj. Marrja në konsideratë e të tërë përbërësve të fenomenit do të ishte kusht për mbarëvajtjen dhe efikasitetin e ligjeve të propozuara për të luftuar këtë fenomen. Në rastin tonë fokusimi i ligjit mbi fenomenin e evazionit fiskal


nuk bën gjë tjetër përveçse e zhvendos problemin në një tjetër stad.

Por më e rëndësishme është arsyeja përse ky informalitet është kaq i pranishëm dhe i përhapur? Një konstatim i bërë nga Banka Botërore është se fenomeni i informalitetit është shumë i pranishëm në Federatën Ruse, në Afrikën e Saharasë si dhe në vendet e Amerikës Latine dhe të Azisë Qendrore. Në të njëjtën kohë ky fenomen është shumë i reduktuar në vendet e Azisë Lindore ku presioni rregullator dhe ai fiskal janë shumë të vegjël në krahasim me vendet që vuajnë më shumë nga ky fenomen. Duke u nisur nga ky fakt, mund të nxjerrim dhe përfundimin e parë mbi informalitetin duke argumentuar se: një presion i madh fiskal nga ana e shtetit i shoqëruar më një shkallë të lartë ndërhyrjeje dhe korrupsioni shtetëror është në bazën e fenomenit të informalitetit ekonomik. Nuk mundem këtu të mos bëj paralelin me masat që janë marrë në disa vende europiane mbi fenomenin e prostitucionit, duke penalizuar më shumë gjeneratorët e fenomenit (klientët) sesa përfituesit direkt (prostitutat). Këtu duke pasur kujdes e duke mos marrë në konsideratë veprimtarinë e dënueshme penalisht të "mbrojtësve", të cilët natyrisht ngelen të dënueshëm sipas çdo lloj logjike. Ideja është e thjeshtë: luftë kundër burimit; në rastin konkret, penalizim të klientëve të prostitutave. E njëjta praktikë e thjeshtë mund të përdoret dhe në emër të luftës kundër informalitetit ekonomik, pra një prerje e burimit të informalitetit, pra e korrupsionit shtetëror, e shoqëruar me një ndërhyrje sa më të paktë të shtetit në marrëdhënie me biznesin. Logjika mbrapa këtij arsyetimi është: një mbipranë e shtetit, që i jep atij një fuqi anormale, e cila hap portat e korrupsionit dhe ky korrupsion sjell si rezultat rritjen e informalitetit, çekuilibrim të ekonomisë, që do të ketë si pasojë një diferencim e ulje të mirëqenies totale. Këtu qëndron edhe paradoksi më i madh i luftës kundër informalitetit, pra duke forcuar mjetet e luftës, prodhojmë më shumë informalitet. E thënë në gjuhën e popullit: duke dashur të heq vetullat, nxjerr sytë. Kështu pra, mbi këtë logjikë, masat shtrënguese të marra në kontekstin shqiptar kanë më shumë gjasa të kenë efekte negative, sesa rezultate efektive ndaj fenomenit. Nga literatura që trajton këtë fenomen, kemi një përgjigje të drejtë dhe pa ekuivoqe përsa i përket luftës kundër informalitetit.

Në rastin e përqafimit të opsionit të masave shtrënguese dhe presionit shtetëror me anë të gjobave të parapagueshme, i duhet kushtuar një vëmendje e jashtëzakonshme kontekstit socio-kulturor. Konstatimi i bërë nga literatura është i qartë: në një kontekst të mbarsur me informalitet, masat shtrënguese nuk prodhojnë efektin e dëshiruar. Mendoj se jemi të tërë në një mendje se informaliteti në shoqërinë shqiptare është shumë i pranishëm. Këtë konstatim evident na i faktijnë ngjarje të hidhura si: fjala vjen fenomeni i piramidave, ai i gjakmarrjes,

por dhe fenomene të përditshme të shoqërisë shqiptare si burokracia dhe procedurat e pafundme administrative në zgjidhjen e një problemi. Këto fenomene kanë treguar dhe tregojnë dobësinë e shtetit shqiptar për t'i dhënë përgjigje problemeve të qytetarëve. Njëkohësisht ato tregojnë edhe prirjen e këtyre të fundit për t'i dhënë zgjidhje problemeve të tyre në një rrugë joformale duke anashkaluar shtetin. Pra si rrjedhojë, duke iu referuar dhe eksperiencës, mendimi të nxjerrim përfundimin se zbatimi i një ligji si ky i "gjobave në biznes" i hap rrugën rritjes së informalitetit në vend.


Në qoftë se i referohemi teorisë ekonomike, një nocion shumë i thjeshtë, por mjaft i rëndësishëm është dhe ai që në zhargon quhet kurba e Laffer-it:



Ideja është e thjeshtë. Duke u nisur nga pika A, një ngarkesë më e madhe fiskale, kthehet në një frien për të ardhurat fiskale. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me ekuilibrin ekonomik pas ligjit të votuar nga legjislatori shqiptar: duke marrë masa shumë represive padashur ose me dashje (vlerësimi i takon më shumë politikës sesa teknikës) do rrisim nivelin e informalitetit në vend. Mbi këtë logjikë dhe jo vetëm, në shtete të zhvilluara si SHBA apo Anglia, por dhe shtete të zhvilluara rishtaz si Japonia, Singapori apo Tajvani, ndërhyrja e shtetit në ekuilibrat ekonomikë është shumë e moderuar.

Një tjetër aspekt, të cilin nuk duhej ta shmangim në analizën e bërë mbi marrjen e masave shtrënguese si "ligji i gjobave", është dhe fakti i besueshmërisë negociuese të ekonomisë dhe kompanive shqiptare me partnerët e saj të huaj. Në një kohë që për ekonominë shqiptare një pjesë e madhe e oksigjenit vjen nga investimet e huaja, sinjali i dhënë investitorëve të huaj është që tashmë biznesi dhe interesat e tyre nuk do të varen nga aftësia dhe konkurrenca e lirë, por nga një organizëm shtetëror me një emër shumë të dyshimtë si jashtë, ashtu dhe brenda vendit.

Lomnitz në artikullin e saj "Informal Exchange Networks in Formal Systems: A Theoretical Model", të botuar në revistën American Anthropologist në 1987, nën postulatën "Rregulli krijon parregullsi" argumenton se kontrolli ekstrem i shtetit në biznes nëpërmjet rregullave e kontrolleve shtrënguese, shumë shpesh çon në një rritje të aktiviteteve ilegale. Kjo gjë ilustron dhe në figurën e mëposhtme:



I të njëjtit mendim është dhe sociologu dhe ekonomisti njohur Richard Adams, i cili në vitin 1975 ka shkruar se "sa më shumë mendohe mi të organizojmë shoqërinë dhe ekonominë, aq më shumë i reziston ajo aftësive të shtetit për ta organizuar".

NDËRHYRJET E SHTETIT

Po a duhet të rrijë shteti duarkryq përballë nivelit të lartë të informalitetit? Në asnjë mënyrë jo. Por ka disa faktorë, të cilët bëjnë që kjo luftë legjitime të jetë efektive dhe efiçiente në të njëjtën kohë.

Së pari, duhet që në vend që shteti dhe legjislatori shqiptar të përdorë ligje si ky i "gjobave të biznesit" (në rastin e Shqipërisë e cila është totalisht e paaftë dhe e pafuqishme në administrimin e ligjeve të kësaj natyre), ai duhet të fokusojë energjitë e tij në aspektin zbatues.

Së dyti, shteti dhe legjislatori shqiptar me karakteristikat e tij duhet të ketë një sjellje proaktive me grupet e interesit dhe me shoqërinë civile për t'i servirur biznesit shqiptarë një ligj të bazuar në karakteristikat dhe strukturën e tij.

Së treti, që një ligj të jetë i zbatueshëm duhet që në radhë të parë të jetë i perceptuar si legjitim dhe si i mirëpritur. E në rastin konkret, nga grupet e interesit direkt, ky ligj nuk konsiderohet si i tillë.

Mbas këtyre argumenteve të përgjithshme, por shumë domethënëse, në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në biznesin e lirë me justifikimin e luftës kundër informalitetit, duke lënë mënjanë argumentet politike, arrijmë në përfundimin që "ligji i gjobave" është mënyra më e papërshtatshme që qeveria shqiptare zgjodhi për të luftuar informalitetin në përgjithësi dhe evazionin fiskal në veçanti. Qeveria dhe legjislatori shqiptar duhet të ketë parasysh një fakt: megjithëse integrimi në strukturat europiane dhe euroatlantike është bërë një qëllim në vetvete për qeveritë që vijnë e shkojnë, duhet të mos harrojmë që ky qëllim përbëhet në thelb nga një material dhe provë e vetme, ajo e rritjes së mirëqenies, e modernizimit të ekonomisë gjë e cila vjen me braktisjen e praktikave të vjetra që ekzistojnë në Shqipëri, siç është dhe ky ligj i ri me mentalitet të vjetër i "gjobave të biznesit". ■